REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA –SUHAREKË
OPSTINE SUVA REKA

04-03-2026

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMU
REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTI
REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIP
MARRË NË DORËZIM-PRIML
ECEIVED

Njësia org. / Org. Jedinica / Org. Untt	Numri / Broj / Number	Shtoj / Prilog / Appendix	Vlera / Vrednost / Value
01	016	46001	-

11.Nr	**Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhëneien për shfrytëzim afatshkurter dhe afatëgjatë të pronës së palujteshme të Komunës**	**Datë:** **04.09.2026**

Në bazë të Vendimit Nr.01/016/19545, të datës 30.04.2026, të Kuvendit Komunal, si dhe në bazë të Vendimit për formimin e Komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave Nr.01/410/28768 të datës 24.06.2026, sipas Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe në bazë të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, komisioni përkatës shpall:

KONKURIM I HAPUR Nr. 01/2026

Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite të pronës së paluajtshme

Parcela **P-72116046-00545-6**, me sipërfaqe të përgjithshme **S = 348m²**, sipas certifikatës së pronës **Nr. 11-463-740/2026**, datë **30.07.2026**, në zonën kadastrale **Suharekë**, vendi i quajtur **Fshat**, e evidentuar si pasuri shoqërore në emër të **Komunës së Suharekës.**

Deshmitë e kërkuara:

1. Kopja e dokumentit të identifikimit për person fizik / juridik.
2. Certifikata e regjistrimit të biznesit (për personat juridik).
3. Dëshmi për kryerjen e obligimeve komunale:
- për personat fizikë: tatimi në pronë
- për personat juridik: taksa komunale dhe tatimi në pronë.

4. Deklarata vjetore nga ATK.

5.Dëshmi për kryerjen e obligimeve ndaj ATK-së

6.Garancioni bankar nga bankat ose kompanitë e sigurimeve të licencuara 10% e vlerës investive të projektit, i cili garancion duhet të sillet para nënshkrimit të kontratës.

Kriteret e kërkuara:

• Oferta ekonomikisht më e favorshme- **10% të pikëve**

• Dëshmi për mundësi të realizimit të projektit si: qarkullimi bankar për dy vitet e fundit, marrëveshjet me ndonjërën nga bankat komerciale në Kosovë apo marrëveshje të noterizuar (konsercium) me operatorët ekonomik-**10% të pikëve**
• Poseduesi i njësisë kadastrale në bazë të të drejtave të tij pronësore-juridike i takojnë jo më pak se **29%** e ndërtimit **BRUTO** (banesa dhe lokale afariste të cilat duhet t'i paraqesë në bazë të përqindjes (%) në secilën etazhë të ndërtimit-**60% të pikëve.**
• Plani dinamik -**20% të pikëve.**

Vërejtje:

• Aplikimi me mungesë të ndonjërit prej dokumenteve nënkupton diskualifikim.
• OE / personi fizik ka të drejtë të tërhiqet nga ankandi publik jo më vonë se 1 (një) ditë para mbajtjes së ankandit publik.
• Oferta duhet të dorëzohet në dy ekzemplarë: një origjinal dhe një kopje, të mbyllura në zarf.

Afati për tërheqjen e formularit të ofertave është deri më datë **17.09.2026**, në zyrën pritëse të Gjendjes Civile, Komuna e Suharekës.

Afati i dorëzimit të ofertave është deri më datë **18.09.2026**, deri në **ora 13:30**, në zyrën pritëse të Gjendjes Civile, Komuna e Suharekës. Oferta duhet të jetë e protokolluar.

Hapja e ofertave bëhet më datë **18.09.2026, në ora 14;00**, në sallën e bordit në Komunën e Suharekës.

Hapjen dhe vlerësimin e ofertave e bën komisioni përkatës i Kuvendit të Komunës së Suharekës.

Informata shtesë:
Nr. tel.: 029 271 708
Mob.: 049 838 387
Email: Mensur.selimaj@rks-gov.net

Kryesuesi i Komisionit
Mensur Selimaj